



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E SHËRBIMIT PËR TATIMPAGUESIT
Sektori i Asistenës dhe Shërbimit

Nr. 35738/1 Prot.

Tiranë, më 7.12.2016

Lënda: Kthim përgjigje

Drejtuar: Znj. Nertila Dosti
Tema TV
Njësia Bashkiake nr.5, Rruga Ismail Qemali, Pallati nr.10, Kati 2

TIRANË

E nderuar Znj. Dosti,

Në cilësinë e kërkueses, keni depozituar në formë shkresore, kërkesat për informacion, protokolluar në DPT me nr.35741 Prot, nr. 35740 Prot, nr.35739 Prot. Nr.35738 Prot. Datë 31.10.2016 si dhe në regjistrin e kërkesave me numër rendor 6,7,8, 9 datë 03.11.2016 bazuar në Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", me anën e së cilave bazuar në të drejtën që ju njeh ligji i sipërpërmendur, kërkonti informacion lidhur me kontratën e prokuruar dhe zbatimin e kontratës me objekt "Mbajtje në funksion të pandërprerë të sistemit E-Tax".

Pas shqyrtimit të kërkesave, të cilat ishin në përputhje me nenin 11 të Ligjit nr.119/2014, "Për të drejtën e Informimit", në respektim edhe të parashikimeve konkrete të nenit 7, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", ju informojmë si vijon:

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve ka zhvilluar procedurën e prokurimit me objekt: "Mbajtje në funksion të pandërprerë të sistemit E-Tax, mbi bazën e së cilës është lidhur Kontrata Nr. 31723/19 datë 15.04.2015, botuar në Buletinin e Njoftimeve Publike të Agjencisë së Prokurimit Publik Nr. 17 datë 04.05.2015.

Shuma e kësaj kontrate është 560 000 000 (pesëqind e gjashtëdhjetë milion) lekë me TVSH për 4 vjet.

Bashkëlidhur kësaj përgjigjeje, sipas kërkesës tuaj, do të gjeni edhe dokumentacionin shkresor të administruar në harmoni me parashikimet ligjore në fuqi.

Lidhur me kërkesat për vënie në dispozicion të Raportimeve mujore të Operatorit Ekonomik dhe listën e personave të angazhuar prej tij në realizimin e kësaj kontrate, në kushtet që ky informacion nuk është i lidhur drejtpërdrejt me ushtrimin e funksionit publik të autoritetit publik, por të dhëna tregëtare dhe konfidenciale të Operatorit Ekonomik, si dhe në kushtet që dhënia e këtij informacioni do të cënonte sekretin tregëtar të tatimpaguesit dhe do të binte ndesh me ruajtjen e kofidencialitetit të të dhënave (parashikuar nga neni 17, i ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” dhe nenet 24 dhe 25 të Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, informacioni i mësipërm nuk mund t’ju vihet në dispozicion.

Kjo përgjigje ju dërgohet zyrtarisht nëpërmjet Postës Shqiptare si dhe e skanuar në adresën tuaj të postës elektronike: nertiladosti@gmail.com.

Ju falenderojmë për mirëkuptimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

VASILIKA VJERO





D

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DREJTORIA E ADMINISTRATËS DHE PROKURIMEVE
Sektori i Prokurimit

Nr. 31723/ Prot.
114

Tiranë, më 06/04/ 2015

URDHËR PROKURIMI

Mbështetur në Ligjin 9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), në VKM nr 914 dt.29.12.2014 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", (i ndryshuar), neni 60, "Urdhëri i Prokurimit",

URDHËROJ:

Të kryhet prokurimi i fondit prej:

466 666 667 (katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë), lekë pa TVSH.

vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, për 4 (katër) vjet, për tenderin me objekt: "Mbajtje në funksion të pandërprerë të sistemit e-TAX".

- Viti I-rë (Prill 2015-dhjetor 2015)- 116 666 670 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.
- Viti II-të (2016) -198 333 337 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
- Viti III-të (2017)- 75 000 000 (shtatëdhjetë e pesë milion) lekë pa TVSH.
- Viti IV-ët (2018) -75 000 000 (shtatëdhjetë e pesë milion) lekë pa TVSH.
- Viti V-të (deri në muajin prill 2019) 1 666 667 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Lloji i procedurës së prokurimit të jetë: **Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.**

Arsyet e përdorimit të procedurës së prokurimit:

Kjo procedurë është përzgjedhur pasi operatori, ka të drejtën ekskluzive për shërbimin "Mbajtje në funksion të pandërprerë të sistemit e-TAX".

Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhëri: Njësia e Prokurimit e përbëre nga:

Brunilda Hasani Përgjegjëse Sektori

Flora Gorica Specialiste

Erinda Çarçani Juriste

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM

BRISIDA SHEHAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCAVE
DREJTORIA E PERGJITHSHME E TATIMEVE

Nr. 31723 / Prot.
18

Tiranë, më 14/4 / 2015

RAPORT PËRMBLEDHËS

Mbi procedurën e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit me objekt: “Mbajtje në funksion të pandërprere të sistemit E-Tax”

Znj. Drejtor i Përgjithshëm!

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 68, “Raporti Përmbledhës” paraqet Raportin Përfundimtar, lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “Mbajtje në funksion të pandërprere të sistemit E-Tax” me fond limit:

466 666 667 (katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë), lekë pa TVSH, vënë në dispozicion nga Buxheti i Shtetit, për 4 (katër) vjet :

- Viti I-rë (Prill 2015-dhjetor 2015)- 116 666 670 (njëqind e gjashtëmbëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.
- Viti II-të (2016) -198 333 337 (njëqind e nëntëdhjetë e tetë milion e treqind e tridhjetë e tre mijë e treqind e tridhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.
- Viti III-të (2017)- 75 000 000 (shtatëdhjetë e pesë milion) lekë pa TVSH.
- Viti IV-ët (2018) -75 000 000 (shtatëdhjetë e pesë milion) lekë pa TVSH.
- Viti V-të (deri në muajin prill 2019) 1 666 667 (një milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë) lekë pa TVSH.

Me procedure me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit pasi operatori ka te drejten ekskluzive.

Adresa: Rr. Gjin Bue Shpata, pranë Stadiumit Dinamo
Tel: ++ 355 42276800, Fax: ++355 42276805

Web site: www.tatime.gov.al.

Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve më datë 02.03.2015, zhvilloi procedurën e prokurimit me objekt: "Mbajtje në funksion të pandërprerë të sistemit E-tax", me procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, për shkak se operatori WedoIT-Solutions GmbH, ka të drejtën ekskluzive për kryerjen e shërbimit të kërkuar, vertetuar, kjo edhe me çertifikatën për të drejtën e autorit për kompaninë **WedoIT-solutions GmbH**, lëshuar në qytetin e Vjenës, (Austri), si vend, anëtar i Konventës së Bernës konventë në të cilën aderon edhe shteti shqiptar që nga viti 1993 me dekretin nr. 487 datë 09.03.1993 "Për aderimin e RSH në Konventën e Bernës, "Për mbrojtjen e Veprave Letrare dhe Artisitike" dhe si e tillë kjo çertifikatë është e vlefshme edhe për territorin shqiptar

Pas përfundimit të procedurave të shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertës së paraqitur, autoriteti kontraktor, në prag të lidhjes së kontratës, me shkresën Nr. 31723/10 datë 09.03.2014, i kërkoi subjektit të lartpërmendur, meqënëse është një operator i huaj, hapjen e një përfaqësie tatimore në Republikën e Shqipërisë, për efekt të pagesës së Tatimit mbi Vlerën e Shtuar.

Me shkresën Nr.31723/13 Prot. datë 31.03.2015, nga subjekti WedoIT-Solutions GmbH, Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve u vu në dijeni se subjekti WedoIT-Solutions GmbH, Sidgasse 21/1/11,1030 Vjenë, ka degë në Republikën e Shqipërisë, të regjistruar me NIPT L31912011D.

Në këto kushte, operatori duhet te paraqesë dhe të vërtetojë përpara autoritetit kontraktor, përmbushjen e kapaciteteve ligjore, teknike dhe financiare të degës në Republikën e Shqipërisë.

Per arsyen e lartpërmendur Autoritetit Kontraktor, në mbështetje të nenit 24, të ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik", për shkaqe që dalin jashtë kontrollit të autoritetit kontraktor dhe të paparashikueshme në kohën e fillimit të procedurës së prokurimit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të transparencës, sipas përcaktimit në rregullat e prokurimit publik vendosi të anullojë procedurën e prokurimit me objekt: "Mbajtje në funksion të pandërprerë të sistemit E-Tax me procedurë me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit, për shkak të së drejtës ekskluzive të operatorit.

Kjo procedurë u përsërit me qëllim që operatori ekonomik te paraqesë dhe të vërtetojë përpara autoritetit kontraktor, përmbushjen e kapaciteteve ligjore, teknike dhe financiare të degës se tij në Republikën e Shqipërisë.

Urdhëri i prokurimit :

Nr. 31723/14 Prot. date 06.04.2015

Urdhëri për krijimin e KVO-së:
Pergjithshem.

Nr. 31723/15 Prot date 06.04.2015 i Drejtorit te

Me shkresën nr. 31723/16 Prot. Date 09.04.2015, drejtuar shoqërisë WedoIT-Solutions GmbH eshte dërguar ftesa për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit.

Operatori WedoIT-Solutions GmbH iu pergjigj ftesës së Autoritetit Kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe u paraqit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve ne datën 14.04.2015, ora 10:00, siç ishte përcaktuar në shkresën e lartpërmendur.

Pas verifikimit të dokumentacionit ligjor, teknik dhe ekonomik financiar të këtij operatori nga Komisioni i Vleresimit te Ofertave, rezultoi se shoqëria WedoIT-Solutions GmbH me Nr. NIPTI L31912011D, degë e shoqërisë së huaj, ka paraqitur dokumentacionin e kërkuar dhe ka përmbushur kërkesat e vendosura nga Autoriteti Kontraktor.

Pas shqyrtimit të ofertes ekonomike rezultoi se operatori ekonomik, "WedoIT-Solutions GmbH" ka paraqitur një ofertë ekonomike me vlerë 466 666 667 (katërqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e shtatë), lekë pa TVSH.


Pas bisedimeve të këtij ofertuesi ekonomik, me Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, për negociimin e vleres se ofertës ekonomike, kjo ofertë nuk ndryshoi.

Në këto kushte Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi që operatori ekonomik, WEDOIT-SOLUTIONS GMBH, me Nr. NIPTI L31912011D, degë e shoqërisë së huaj WEDOIT-SOLUTIONS GMBH, Seidlgasse 21/1/11, 1030 Vienna, Austria, me adresë: Godina "Gjergji Center", Rr."Murat Toptani", Kati 6, Tirane ka plotësuar dokumentacionin sipas kërkesave të paraqitura nga Autoriteti Kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe vendosi të kualifikojë operatorin e vetem ekonomik WEDOIT-SOLUTIONS GMBH, me Nr. NIPTI L31912011D.

Komisioni Vlerësimit të Ofertave

Artan DELIU
Mimoza SERAJ
Albana PLOCI

Kryetar
Anëtare
Anëtare



Për Autoritetin Kontraktor

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Brisida SHEHAJ

